

IFLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

SIPROLIP

Tableta të veshura me film – 10 mg, 20 mg, 40 mg *(Simvastatinë)*

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

- Çfarë është Siprolip dhe përse përdoret?
- Përpara se të merrni Siprolip
- Si ta merrni Siprolip?
- Efekte anësore të mundshme
- Si ta ruani Siprolip?
- Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË SIPROLIP DHE PËRSE PËRDORET

Siprolip është një bar nga klasa e frenuesve të enzimës pjesëmarrëse në sintezën e kolesterolit, i cili përdoret për të ulur nivelin e lipideve në gjak (kolesterolit). Lënda aktive e Siprolip, simvastatina, zvogëlon prodhimin e kolesterolit në mëlçi. Për simvastatinën është parë se në pacientët me risk të lartë për sëmundjet koronare të zemrës, zvogëlon rrezikun e infarktit të zemrës ose të insultit.

Siprolip përdoret:

si shtesë e një diete në:

- pacientë me hiperkolesterolemi (primare ose hiperlipidemi mikse) ku dieta dhe masa të tjera si aktiviteti fizik apo humbja në peshë nuk janë të mjaftueshme të vetme
- pacientë me hiperkolesterolemi homozigote familjare, e shoqëruar me mjekime të tjera ose kur këto nuk janë të përshtatshme;

për parandalimin e sëmundjeve kardiovaskulare:

- në pacientë, niveli i kolesterolit në gjak të të cilëve është normal ose i lartë, me sëmundje kardiovaskulare arteriosklerotike ose diabet, të bashku me masa të tjera parandaluese.

2. PËRPARA SE TË MERRNI SIPROLIP

Mos merrni Siprolip:

- në qoftë se jeni hipersensitiv (alergjik) ndaj simvastatinës apo ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të Siprolip,
- në qoftë se keni probleme të mëlçisë ose nivel të lartë të vazhdueshëm të pashpjegueshëm të disa enzimave të mëlçisë (transaminaza serike),
- në qoftë se jeni shtatzënë ose duke ushqyer me gji,
- në qoftë se jeni duke u mjekuar me disa barna të cilat frenojnë fuqishëm eleminimin normal të simvastatinës nga trupi, të tilla si: itrakonazol, ketokonazol, inhibitorët e proteazës së HIV, eritromicinë, klaritromicinë, telitromicinë dhe nefazodon (shiko pikën 2 "Marria e Siprolip me barna të tjera").

Tregoni kujdes të veçantë me Siprolip

Njoftoni mjekun tuaj për të gjitha problemet shëndetësore të pranishme dhe të mëparshme.

Gjatë mjekimit me Siprolip mjeku juaj do t'ju mbikqyrë në qoftë se keni sëmundje të sheqerit në gjak (diabet) ose riskun e zhvillimit të kësaj sëmundjeje. Risku i zhvillimit të sëmundjes së sheqerit në gjak është kur ju keni nivele të larta të sheqerit në gjak dhe të yndyrnave në gjak, jeni mbipeshë dhe keni presion të lartë të gjakut.

Çrregullime muskuloskeletore

Si statinat e tjera, simvastatina, lënda aktive e Siprolip, nganjëherë bëhet shkak për zhvillimin e një sëmundjeje të muskujve skeletorë (miopati) e cila shkakton dhimbje muskujsh, brishtësi ose dobësi, e shoqëruar me një rritje të dukshme të disa testeve laboratorike (kreatinë kinazë).

Ndonjëherë miopatia manifestohet me rabdomiolizë (shkatërrim i qelizave të muskujve skeletorë) me ose pa insuficiencë akute renale, shumë rrallë me përfundim fatal. Risku i miopatisë rritet me rritjen e dozës së simvastatinës.

Sforcimi i rëndë fizik mund të çojë në rritjen e vlerave laboratorike të kreatinë kinazës. Prandaj, kjo vlerë laboratorike nuk mund të matet gjatë aktivitetit të rëndë fizik ose në prani të ndonjë shkakui tjetër bindës që shkakton rritje të saj, sepse këto bëjnë të vështirë vlerësimin e këtyre vlerave. Në qoftë se vlerat e kreatinë kinazës rriten në mënyrë të dukshme (më shumë se pesë herë vlera maksimale e normës), matjet duhet të përsëriten pas 5-7 ditësh për të konfirmuar rezultatet.

Në qoftë se gjatë mjekimit me Siprolip vini re dhimbje të pashpjegueshme muskujsh, brishtësi apo dobësi të muskujve, ju lutemi të njoftoni mjekun tuaj menjëherë.

Mjeku juaj do t'ju kontrollojë rezultatet laboratorike për të sqaruar ndonjë emergjencë të mundshme të sëmundjes së muskujve (miopati). Mjekimi me Siprolip duhet të ndërpritet në qoftë se vlerat laboratorike rriten në mënyrë të theksuar (më shumë se pesë herë vlera maksimale e normës së kreatinë kinazës), ose në qoftë se mjeku juaj ka përcaktuar ose dyshon për miopati. Në qoftë se shqetësimet e përditshme konsistojnë në dhimbje të rënda muskujsh, duhet konsideruar ndalimi i mjekimit, edhe në qoftë se vlera e kreatinë kinazës është më pak se pesë herë vlera maksimale e normës.

Trajtimi me Siprolip duhet të ndërpritet përkohësisht për disa ditë përpara ndonjë ndërhyrjeje kirurgjikale dhe në prani të ndonjë sëmundjeje serioze.

Mjekimi me Siprolip duhet bërë vetëm pas një vlerësimi të kujdesshëm përfitim-risk dhe nën mbikqyrjen mjekësore në qoftë se:

- jeni tashmë më shumë se 70 vjeç,
- keni mosfunksionim të veshkave,
- keni hipotroidizëm të pamjekuar,
- keni miopati të trashëguar ose histori mjekësore familjare për të,
- keni patur miopati gjatë trajtimit me statina ose fibrate,
- ka abuzim me alkoolin.

Mosfunksionimi i mëlçisë

Në studimet klinike, në disa pacientë të rritur të cilët morën simvastatinë, u vu re rritje e zgjatur në kohë (më shumë se tre herë vlera maksimale e normës) në disa teste të funksionit të mëlçisë. Pas ndërprerjes apo mbarimit të mjekimit, përgjithësisht vlerat ranë ngadalë në nivelet e normës.

Mjeku duhet të kontrollojë funksionin e mëlçisë (përcaktimin e transaminazave) në fillim të trajtimit dhe më pas në qoftë se nevojitet (shiko pikën 4 "Efekte anësore të mundshme"). Duhet të bëhen kontrole shtesë në dozat ditore të simvastatinës prej 80 mg (përpara rritjes së dozës, tre muaj pas rritjes së dozës deri në 80 mg dhe më pas në mënyrë periodike [p.sh. çdo glysëm vit] në vitin e parë).

Në rast të rritjes në mënyrë të dukshme të enzimave të mëlçisë, mjeku juaj duhet të përsërisë analizën menjëherë dhe të kontrollojë rregullisht këto vlera. Bari duhet të ndërpritet në qoftë se rritja e vlerave vazhdon, veçanërisht në qoftë se ato shkojnë sa tre herë vlera maksimale e normës dhe persistojnë.

Duhet patur kujdes të veçantë në rastet kur keni vuajtur më parë nga sëmundje të mëlçisë ose keni konsumuar sasi të mëdha alkooli.

Gjatë mjekimit me simvastatinë, ashtu si edhe me barna të tjera të përdorura për uljen e nivelit të lartë të lipideve në gjak, janë vënë re rritje të moderuara të transaminazave në serum (më pak se tre herë vlera maksimale e normës). Këto devijime kanë ndodhur menjëherë pas fillimit të mjekimit me simvastatinë. Ato ishin tranzitore, jo të shoqëruara me ndonjë simptomë dhe ndërperja e mjekimit nuk ishte e nevojshme.

Probleme me frymëmarjen

Filsi në mjekun ose farmacistin tuaj përpara mjekimit me Siprolip në qoftë se vuani nga probleme të frymëmarrjes.

Fëmijët

Siguria dhe efikasiteti janë shqyrtuar të djemtë e moshës 10-17 vjeç dhe të vajzat menstruacioni i parë i të cilave kishte ndodhur të paktën një vit më parë (shiko pikën 3 "Si ta merrni Siprolip?").

Simvastatina nuk është studiuar në fëmijët nën 10 vjeç. Më shumë informacion për këtë temë mund të merrni nga mjeku juaj.

Njerëzit e moshuar

Për njerëzit e moshuar nuk nevojitet rregullim i dozës.

Në qoftë se jeni më shumë se 70 vjeç, mjekimi me Siprolip duhet bërë me kujdes dhe nën mbikqyrjen mjekësore.

Marria e Siprolip me barna të tjera

Ju lutemi, njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë/përdorur ose keni marrë/përdorur kohët e fundit çdo lloj bari tjetër, duke përfshirë edhe ato pa recetë. Në rast se ju jepen receta të reja, informoni mjekun që ju jeni tashmë duke marrë Siprolip.

Bashkadministrimi i barnave ose grupeve të barnave të mëposhtme me Siprolip mund të ndikojë në efektin e Siprolip dhe / ose të barnave të tjera. Për të shmangur efektet anësore, veçanërisht në muskuj dhe në mëlçi, dhe për të arritur efektin e dëshiruar, në çdo rast, mund të lindë nevoja e rregullimit të dozës së Siprolip dhe / ose të barnave të tjera. Mund të lindë nevoja e ndërprerjes ose ndërrimit të mjekimit. Duhet të flisni me mjekun tuaj, veçanërisht në qoftë se jeni duke marrë ndonjë ose më shumë nga barnat e renditur më poshtë.

Duhet patur kujdes gjatë mjekimit në të njëjtën kohë me Siprolip dhe barnat ose grupet e barnave të përmendura më poshtë:

- Barna për mjekimin e çrregullimeve në metabolizmin e lipideve të cilat edhe kur administrohen vetëm mund të shkaktojnë çrregullime në muskujt skeletorë:

Gembfibrozil, fibrate të tjera dhe niacinë (acid nikotink; ≥ 1 g/ditë).

Në qoftë se ndonjë nga këto barna (me përjashtim të fenofibratit) merret së bashku me Siprolip, doza e simvastatinës nuk duhet të kalojë 10 mg në ditë (shiko pikën 3 "Si ta merrni Siprolip?").

Gembfibrozili mund të rrisë gjithashtu nivelin e simvastatinës në gjak.

Nuk ka të dhëna për fenofibratin që të shkaktojë nga bashkadministrimi risk më të madh për këtë sëmundje se sa nga marria e këtyre barnave veç e veç.

Sidoqoftë, duhet treguar kujdes sepse secili nga këto barna i vetëm mund të shkaktojë miopati. Për fibratet e tjera nuk ka të dhëna të tjera të mjaftueshme.

- Barna të cilat rrisin riskun për dëmtim muskular duke ndërhyrë në eleminimin normal të simvastatinës nga trupi:

Siprolip nuk duhet të merret me barnat vijues: itrakonazol dhe ketokonazol (barna kundër kërpudhave patogjene), eritromicinë, klaritromicinë dhe telitromicinë (antibiotikë), inhibitorët të proteazës së HIV (përdorur për të mjekuar AIDS) dhe nefazodon (një antidepressant). Në qoftë se mjekimi me itrakonazol, ketokonazol, eritromicinë, klaritromicinë ose telitromicinë është i nevojshëm, mjekimi me Siprolip duhet ndërprerë.

Duhet patur kujdes kur simvastatina merret me barnat që vijnë: ciklosporinë (e përdorur për suprimimin e sistemit imunitar), verapamil dhe diltiazem (të përdorur për trajtimin e sëmundjeve të ndryshme kardiovaskulare) (shiko më poshtë).

- Ciklosporinë (bar i përdorur për suprimimin e sistemit imunitar):

Risku për miopati rritet nga marria në të njëjtën kohë e dozave të larta të simvastatinës doza të larta, me ciklosporinë. Prandaj, në pacientët e trajtuar me ciklosporinë, nuk duhet tejkaluar doza prej 10 mg e simvastatinës (shiko pikën 3 "Si ta merrni Siprolip?").

- Verapamil, amiodaron dhe gjithashtu diltiazem (barna të përdorur për trajtimin e sëmundjeve të ndryshme kardiovaskulare):

Risku për miopati rritet nga marria në të njëjtën kohë e dozave të larta të simvastatinës me amiodaron ose verapamil. Prandaj, te pacientët të cilët marrin amiodaron ose verapamil, nuk duhet tejkaluar doza ditore e simvastatinës prej 20 mg (shiko pikën 3 "Si ta merrni Siprolip?"), në rastin kur përfitimet nuk e tejkalojnë riskun e rritur për miopati.

Pacientët të cilët mjekohen me diltiazem dhe 80 mg simvastatinë në ditë, kanë një rritje të lehtë të riskut për miopati. Prandaj, te pacientët të cilët marrin diltiazem, doza e simvastatinës prej 40 mg nuk duhet tejkaluar.

Për riskun e dëmtimit të muskujve shiko gjithashtu sipër nën pikën "Tregoni kujdes të veçantë me Siprolip, Çrregullime muskuloskeletore".

- Barna për parandalimin e mpiksjes së gjakut (antikoagulantët oralë): Në qoftë se jeni mjekuar në të njëjtën kohë me barna të derivatave të kumarinave (të tilla si varfarinë, fenprokumon, acenokumaro) për të zvogëluar mpiksjen e gjakut, mund të ndodhë një rritje e lehtë e efektit antikoagulant. Prandaj duhet përcaktuar koha juaj e protrombinës në fillim dhe gjatë mjekimit me Siprolip, dhe në ndryshim e dozës apo ndërprerjen e Siprolip, në qoftë se ju jeni duke marrë barna të tillë antikoagulantë. Pas kësaj, koha e protrombinës mund të kontrollohet në intervalet e zakonshme.

Në qoftë se prej gjendjes suaj shëndetësore ndihet e nevojshme marria e këtyre barnave, mjeku juaj do të vendosë në qoftë se përfitimet e mjekimit shoqërues i tejkalojnë rreziqet e përfshira ose nëse është i mundur një mjekim i ndryshëm ose nëse mjekimi me Siprolip mund të ndërpritet. Në qoftë se vendoset për mjekimin shoqërues me Siprolip, duhen patur parasysh rekomandimet e veçanta të dozimit (shiko pikën 3 "Si ta merrni Siprolip?"). Vetëm mjeku juaj mund të vendosë për mjekimin tuaj, në një rast të tillë.

Filsi në menjëherë me mjekun tuaj në rast dhimbjesh të pashpjegueshme të muskujve, brishtësi të muskujve ose dobësi të muskujve.

Marria e Siprolip me ushqim dhe pije

Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se konsumoni sasi të mëdha alkooli.

Lëngu i grejfrutit përmban një ose dy përbërës të cilët ndikojnë në metabolizmin e disa barnave, duke përfshirë Siprolip dhe kështu rrisin riskun e sëmundjeve të muskujve. Gjatë mjekimit me Siprolip duhet të evitoni konsumimin e lëngut të grejfrutit.

Shtatzënia dhe ushqimi me gj

Këshillohuni me mjekun ose farmacistin tuaj përpara marrjes / përdorimit të çdo lloj bari.

Siprolip nuk duhet përdorur gjatë shtatzënisë.

Siprolip nuk duhet të merret nga gratë të cilat janë shtatzënë, po planifikojnë të mbeten shtatzënë ose mendojnë se janë shtatzënë. Në qoftë se një grua që është duke u mjekuar me Siprolip, mbetet shtatzënë, ajo duhet të ndalojë mjekimin dhe të njoftojë mjekun e saj menjëherë.

Duke qenë se nuk dihet nëse simvastatina, lënda aktive e Siprolip, kalon apo jo në qumështin e gjirit, Siprolip nuk duhet të përdoret gjatë laktacionit.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Simvastatina nuk ka ose ka një influencë të papërfillshme në aftësinë për të drejtuar automjetin ose përdorur makineri.

Megjithatë, duhen patur parasysh rastet e raportimeve të rralla ku pacientët kanë patur marrje mendsh gjatë drejtimit të mjeteve dhe përdorimit të makinerive.

Informacion i rëndësishëm rreth disa përbërësve të Siprolip

Ky bar përmban laktozë.

Ju lutemi, merrni Siprolip vetëm pasi ju të jeni këshilluar me mjekun tuaj në qoftë se e dini se keni intolerancë ndaj disa sheqernave.

3. SI TA MERRNI SIPROLIP?

Merreni Siprolip ashtu siç ju ka thënë mjeku. Në qoftë se nuk jeni të sigurt këshillohuni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga mjeku, doza e zakonshme është: Dozimi i simvastatinës shkon nga 5 mg në ditë deri në 80 mg në ditë. Doza e zakonshme e rekomanduar për fëmijët (10-17 vjeç) në fillim të trajtimit është 10 mg simvastatinë në ditë si dozë unike në mbrëmje. Doza maksimale e rekomanduar është 40 mg në ditë. Doza prej 80 mg është e rekomanduar për të rriturit me nivel të lartë të theksuar të lipideve në gjak dhe risk të lartë për ndërlikime të shoqëruara me sëmundje kardiake. Në qoftë se është e nevojshme, mjeku juaj mund të rregullojë dozën duke u bazuar në nivelin e kolesterolit në gjak në intervale prej 4 javësh ose më shumë. Për të lehtësuar dozimin individual, tabletat e veshura me film Siprolip mund të gjenden në doza prej 10 mg, 20 mg dhe 40 mg.

Udhëzime të nevojshme:

Për të zvogëluar nivelin e lipideve në gjak:

Pacientë me hiperkolesterolemi (primare ose hiperlipidemi mikse)
Përpara fillimit të mjekimit me Siprolip duhet nisur në dietë e përshtatshme për uljen e kolesterolit, e cila duhet vazhduar gjatë mjekimit.

Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga mjeku, doza e fillimit e rekomanduar është 10 mg deri në 20 mg simvastatinë, si dozë unike një herë në ditë në mbrëmje. Në qoftë se niveli i yndyrnave në gjak duhet të ulet në mënyrë të ndjeshme, duhet të këshillohet një dozë fillimi prej 20 mg deri në 40 mg simvastatinë në ditë. Për rregullimin e dozës, në qoftë se është e nevojshme, duhen patur parasysh përkshkrimet si më sipër.

Pacientë me hiperkolesterolemi homozigote familjare

Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga mjeku, doza e fillimit e rekomanduar është 40 mg simvastatinë në ditë, një herë në ditë si dozë unike në mbrëmje ose 80 mg simvastatinë në ditë e ndarë në 3 doza në ditë, p.sh. dy herë 20 mg gjatë ditës dhe 40 mg në mbrëmje.

Në këta pacientë, ku është e mundur, Siprolip duhet përdorur si plotësues i mjekimeve të tjera të uljes së yndyrnave (p.sh. LDL aferezë).

Për parandalimin e sëmundjeve kardiovaskulare:

Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga mjeku, për pacientët (me nivele normale ose të larta të kolesterolit në gjak) me risk të lartë për sëmundje koronare të zemrës, doza e rekomanduar është 20 mg deri në 40 mg simvastatinë një herë në ditë në mbrëmje.

Mjekimi me këtë bar mund të fillojë në të njëjtën kohë me dietën dhe aktivitetin fizik. Për rregullimin e dozës, në qoftë se është e nevojshme, duhen patur parasysh përkshrimet si më sipër.

Mjekimet e kombinuara me barna të tjera:

Në qoftë se mjeku juaj ju këshillon të merrni Siprolip së bashku me kolestraminë (një shkëmbyes anionesh) ose një shkëmbyes tjetër anionesh, merreni Siprolip të paktën 2 orë përpara ose të paktën 4 orë pas marrjes së shkëmbyesit të anioneve. Në qoftë se mjekoheni në të njëjtën kohë me ciklosporinë (e përdorur për suprimimin e sistemit imunitar), nuk duhet tejkaluar doza prej 10 mg në ditë e simvastatinës. Në qoftë se jeni duke marrë gembfibrozil, fibrate të tjera (me përjashtim të fenofibratit) ose niacinë (acid nikotink) në doza të uljes së lipideve (≥1 g / ditë), nuk duhet tejkaluar doza prej 10 mg në ditë e simvastatinës. Në qoftë se merrni amiodaron ose verapamil (barna për trajtimin e sëmundjeve kardiovaskulare), nuk duhet tejkaluar doza prej 20 mg në ditë e simvastatinës. (Shiko gjithashtu pikën 2 "Përpara se të merrni / Marria e Siprolip me barna të tjera").

Përdorimi në pacientët e moshuar:

Nuk nevojitet rregullim i dozës.

Përdorimi në pacientë me dëmtime të funksionit të veshkave

Në qoftë se vuani nga dëmtime të moderuara të funksionit të veshkave, zakonisht nuk kërkohet rregullim i dozës. Në qoftë se vuani nga dëmtime të rënda të funksionit të veshkave, duhen konsideruar me kujdes dozat mbi 10 mg në ditë simvastatinë, dhe në qoftë se është e nevojshme duhet të përkshruhen me kujdes nga mjeku juaj.

Metoda e administrimit

Ju lutemi të merrni tabletën e veshur me film të shoqëruar me shumë lëngje (një qoftë ujë) në mbrëmje.

Mund ta merrni Siprolip të shoqëruar ose jo me ushqim.

Në disa raste, kur administrohen 80 mg nga goja, mund ta ndani këtë dozë në 3 doza në ditë; merrni dy herë nga 20 mg simvastatinë gjatë ditës dhe 40 mg në mbrëmje.

Kohëzgjatja e trajtimit

Marria e Siprolip është një trajtim tipik afatgjatë. Kohëzgjatja e trajtimit përcaktohet nga mjeku juaj.

Ju lutemi, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se keni përshtypjen se efekti i Siprolip është shumë i fortë ose shumë i dobët.

Në qoftë se merrni më shumë Siprolip sesa duhet

Në qoftë se merrni më shumë tableta të veshura me film se sa ju janë këshilluar, ju lutemi njoftoni mjekun tuaj menjëherë.

Në qoftë se harroni të merrni Siprolip

Mos merrni një dozë të dyfishtë për të zëvendësuar dozën e harruar.

Në qoftë se ndërprisni marrjen e Siprolip

Merreni Siprolip për aq kohë sa ju ka këshilluar mjeku. Në qoftë se ndërprisni mjekimin, niveli i kolesterolit mund të rritet përsëri. Në qoftë se keni pyetje rreth përdorimit të këtij bari, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, simvastatina mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.

Frekuencat e efekteve anësore të mundshme të listuara më poshtë përcaktohen si:

<i>Shumë të zakonshme</i>	Më shumë se 1 në 10
<i>Të zakonshme</i>	1 deri në 10 nga 100
<i>Të pazakonta</i>	1 deri në 10 nga 1,000
<i>Të rralla</i>	1 deri në 10 nga 10,000
<i>Shumë të rralla</i>	Më pak se 1 në 10,000
<i>Të panjohura</i>	Frekuenca nuk mund të vlerësohet nga të dhënat e disponueshme

Çrregullime në sistemin limfatik dhe në gjak:

Të rralla: anemi.

Çrregullime në sistemin nervor:

Të rralla: dhimbje koke, parestezi, marrje mendsh, sëmundje e nervave (neuropati periferike). Të panjohura: çrregullime me gjumin të tilla si: pagjumësi dhe maktsh, depresion, humbje kujtese.

Çrregullime në traktin gastrointestinal:

Të rralla: konstipacion, dhimbje barku, ndjesi fryrjeje, patretshmëri, diarre, nauze, të vjella, inflamacion i pankreasit (pankreatit).

Çrregullime hepatobiliare:

Të rralla: hepatit i fiter.

Çrregullime në metabolizëm dhe ushqyerje:

Të panjohura: diabet. Risku i zhvillimit të një sëmundje të sheqerit në gjak është më i madh në qoftë se keni nivel të lartë të sheqerit dhe të yndyrnave në gjak, jeni mbipeshë dhe keni presion të lartë të gjakut. Mjeku juaj do t'ju mbikqyrë gjatë mjekimit me Siprolip.

Çrregullime në gj dhe në sistemin riprodhues:

Të panjohura: çrregullim i funksionit seksual.